



BASHKIA  
TIRANË

## SHTOJCË

### MBI MODIFIKIMIN DHE NDRYSHIMIN E DOKUMENTAVE STANDARTE TË TENDERIT

Sot më datë 28.05.2020, Njësia e Prokurimit ju bën me dije se:

Autoriteti Kontraktor, në mbështetje të Nenit 42, pika 2 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) si dhe në bazë të Kreut VII, Neni 62, të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), me nismën e vet, vendosi të bëjë ndryshimet në dokumentat e tenderit përmes hartimit të një Shtojce, për procedurën e prokurimit me objekt: **Mbikqyrja e punimeve të objektit “Rindërtimi i banesave individuale, brenda dhe jashtë zonave të reja për zhvillim, ndërtimin dhe rikonstruksionin e infrastrukturës publike si dhe çdo ndërhyrje tjetër në funksion të rindërtimit të banesave individuale, jashtë zonave të reja për zhvillim”** me fond limit: 14,271,497 (katërmëdhjetë milion e dyqind e shtatëdhjetë e një mijë e katërqind e nëntëdhjetë e shtatë) lekë pa TVSH, vënë në dispozicion nga fondi për rindërtimin miratuar me Vendim Nr. 374, datë 6.5.2020, “Për disa ndryshime në Vendimin Nr. 202, datë 5.3.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për përdorimin e fondit të rindërtimit, miratuar në buxhetin e vitit 2020 për financimin e rindërtimit të banesave individuale” te ndryshuar.

Kjo shtojcë u komunikohet menjëherë të gjithë Operatorëve ekonomikë në rrugë elektronike nëpërmjet sistemit elektronik duke u bërë detyruese për ta.

Për sa më lart, Njësia e Prokurimit, vendosi të bëjë ndryshimet përkatëse në Dokumentat Standarte të Tenderit për procedurën e prokurimit me objekt **Mbikqyrja e punimeve të objektit “Rindërtimi i banesave individuale, brenda dhe jashtë zonave të reja për zhvillim, ndërtimin dhe rikonstruksionin e infrastrukturës publike si dhe çdo ndërhyrje tjetër në funksion të rindërtimit të banesave individuale, jashtë zonave të reja për zhvillim”** si më poshtë vijon:

#### Në Shtojcën 14, në pjesën Shënim.

#### ISHTE:

*Operatori ekonomik duhet të paraqesë metodologjinë e punës lidhur me Kohën e zbatimit të kontratës, ku “duhet të tregojë aftësinë për t’i transformuar kërkesat e specifikimeve teknike, preventivin dhe kostot në plan pune konkrete, me qëllim për të realizuar punimet sipas afatit”, si dhe metodologjinë e punës lidhur me Cilësinë “Treguesit dhe analiza cilësore në punë duke përcaktuar elementet e saj si për shembull por pa u limituar në cilësinë e propozimit teknik për sa i përket metodave të përdorura, personelit kryesor, organizimi i sitit, siguria, sigurimit të cilësisë, planit të mobilizimit, grafikut të zbatimit dhe çdo aktiviteti tjetër siç mund të përcaktohet nga punëdhënësi”.*

## BËHET

*Në Fazën 2 – «Paraqitja e ofertës/ lidhja e kontratës», Operatori ekonomik duhet te paraqesë metodologjinë e punës lidhur me Kohën e zbatimit të kontratës, ku “duhet të tregojë aftësinë për t’i transformuar kërkesat e specifikimeve teknike, preventivin dhe kostot në plan pune konkrete, me qëllim për të realizuar punimet sipas afatit”, si dhe metodologjinë e punës lidhur me Cilësinë “Treguesit dhe analiza cilësore në punë duke përcaktuar elementet e saj si për shembull por pa u limituar në cilësinë e propozimit teknik për sa i përket metodave të përdorura, personelit kryesor, organizimi i sitit, siguria, sigurimit të cilësisë, planit të mobilizimit, grafikut të zbatimit, termave të referencës dhe çdo aktiviteti tjetër siç mund të përcaktohet nga punëdhënësi”.*

**Afati kohor për dorëzimin e ofertave ose kërkesave për pjesëmarrje:**

**Data: 08.06.2020, Ora: 11:00**

**Vendi: Në faqen zyrtare të Web-it të APP-së, [www.app.gov.al](http://www.app.gov.al)**

**Afati kohor për hapjen e ofertave ose kërkesave për pjesëmarrje:**

**Data: 08.06.2020, Ora: 11:00**

**Vendi: Në faqen zyrtare të Web-it të APP-së, [www.app.gov.al](http://www.app.gov.al)**